



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:040042
Datë: 06.02.2025
Numri i dokumentit: 06815975

P.nr.30/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.E.për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1446/22 të dt.21.01.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 04.02.2025, ku prezent ishin prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari A.E., me dt.06.02.2025, shpallë dhe e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: A.E., nga i ati Sh. dhe e ëma E. e lindjes I., i lindur më datën ..., në D. Rr. „B. K.” nr. ..., ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i një fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datën 25.07.2022, rreth orës 10:25 minuta, në fshatin C., Komuna e Malishevës, në objektin e hekurishtes „L”, i pandehuri merr pasurin e këtu të dëmtuarit A.H., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që ditën kritike duke shfrytëzuar momentin e volitshëm me veturën e tipit G., ngjyrë e zezë me targa ... me një shenjë dalluese tek shkronjat TDI të shënuar L. ndalet afër kompanisë, fillimisht bisedon me dëshmitarin I.Z.punëtor pranë kësaj kompanie e më pas duke e shfrytëzuar rastin derisa punëtori ishte duke biseduar me një klient tjetër afrohet afër zyrës ku dera ishte e hapur, hyn brenda vjedh kuletën në të cilën kishte 1500 euro para kesh, një letërnjoftimin dhe disa kartëvizita dhe me shpejtësi largohet në drejtim të fshatit A..

– Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së të njëjtit i`a shqipton:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej **dyqind (200) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhironlogarinë e kësaj gjykate 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e cekur, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditësh, duke llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu, si dhe,

-Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit A.E., dënimi me burgim në bazë të nenit 44 par.2 të KPRK-së, të njëjtit i zëvendësohet me dënimin me gjobë në shumë prej njëmijë e dyqind **(1200) euro**.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK- gjykata e gjykon me **DËNIM UNIK**:

Në bazë të nenit 44 par.2 të KPRK-së, gjykata të njëjtit ia shqipton :

DËNIMIN ME GJOBË në shume prej **njëmijë e katërqind (1400) euro** , të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Poqe së dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej shtatëdhjetë (70), duke llogaritur çdo ditë burgu me nga 20 (njëzetë) euro.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumen prej 20 euro, ndërsa 20 euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

I dëmtuari A.H. nga fsh. C., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1446/22 të dt.21.01.2023, e ka akuzuar A.E., për shkak të veprës të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.04.02.2025, ku prezent kanë qenë, prokurori e shtetit Venera Shala, i akuzuari A.E., ndërsa në mungese te të dëmtuarit, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari A.E. në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur,

për të cilin jam penduar, kërkoj falje, të dëmtuarit jam në gjendje tia kthej dëmin, andaj kërkoj nga gjykata që të me shqiptoj një dënim sa më të butë, ku i premtoj gjykatës që në të ardhmen do te jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale, po ashtu i propozoj gjykatës dhe jap pëlqimin se ne rast se me shqiptohet një dënim me burg, të me zëvendësohet me dënimin me gjobë.

Prokurori i shtetit Venera Shala deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së të akuzuarit, dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pa shtytje nga askush, i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe atë përgjegjësinë penale të të akuzuarit si rrethanë rënduese, dashjen e tij për kryerjen e veprës penale, e po ashtu edhe rrezikshmërinë me të cilin i kanoset shoqërisë, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese i propozoj gjykatës që te ketë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin që në të ardhmen nuk do te përsërisë veprimin e njëjtë, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe të obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari A.E.ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i policit M.K., me nr. të rastit ..., të datës 25.07.2022;
- Deklarata e dëmtuarit A.H. dhënë në polici me datë 25.07.2022;
- Deklarata e dëshmitarit I.Z.dhënë në polici me datë 25.07.2022;
- Deklarata e të pandehurit A.E. dhënë në polici me datë 25.07.2022;
- CD-video incizim, nr. rastit ...;
- Foto dokumentacioni;
- Si dhe shkresat tjera të lëndës.

4. Elementet e veprës penale.

Në nenin 313 par.1 të KPRK-së, është parashikuare se: „*Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50)Euro apo më shumë, me qëllim të përvoetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personintjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet*”.

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin A.E. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 me par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, është i gjendjes së dobët ekonomike, i ati i një fëmije, është mbajtës i vetëm i familjes prej 5 antarësh , për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë veprë penale, kështu gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin unik me gjobë në shumë prej njëmijë e katërqind (1400) euro, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.30/2023, me dt.06.02.2025.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.